

EMIL LAFE

## DREJTSHKRIMI DHE GRAFIKA E SHQIPES

Në këtë diskutim të përgjithshëm dhe vendimtar rreth drejtshkrimit të shqipes një nga çështjet që meritojnë të shqyrtohen me kujdes është edhe marrëdhënja ndërmjet drejtshkrimit dhe grafikës.

Grafika, si tërësia e shenjave të shkrimit të një gjuhe, të para në marrëdhënjen e tyre me sistemin fonetik, është në lidhje të ngushtë e të drejtpërdrejtë me ato rregulla të drejtshkrimit që përcaktojnë përdorimin e shkronjave e të shenjave të tjera grafike për shkrimin e një gjuhe.

Sistemi grafik i shqipes është ndërtuar mbi bazën e alfabetit latin. Ky alfabet prej 26 shkronjash paraqet vështirësi për çdo gjuhë që ka më shumë se 26 fonema. Gjuhët që përdorin sot alfabetin latin i kanë zgjidhur këto vështirësi kryesisht në dy mënyra: duke u shtuar shkronjave latine shenja diakritike dhe duke formuar kombinime shkronjash. Kongresi i Manastirit, që caktoi alfabetin tonë të sotshëm, i zbatoi të dyja këto mënyra. Shkronjat *e* dhe *c*, me anë shenjash diakritike u përshtatën për të shprehur fonemat *ë* dhe *ç*; duke përdorur shkronjat *j* dhe *h* si element të dytë u krijuan dyshkronjëshat *gj*, *nj*, *dh*, *th*, *sh*, *zh*, *xh*, dhe nga dyzimi i shkronjave *r* e *l* u krijuan dyshkronjëshat *rr* e *ll*.

Tashti që do të vendosim për hartimin e rregullave drejtshkrimore në trajtë përfundimtare duhet bërë një vlerësim edhe i alfabetit e i grafikës.

Teorikisht ideali i grafikës është: një shkronjë të shënojë vetëm një tingull dhe një tingull të shënohet vetëm me një shkronjë. Por në praktikën e shkrimit raste të tilla pothuajse nuk ka, pasi shkrimi është një kategori historike dhe gjatë zhvillimit të gjuhës krijohen gjithnjë mospërputhje midis sistemit fonetik dhe sistemit grafik.

Duke marrë parasysh, përveç anës shkencore, edhe anën praktike e teknike të shkrimit, një sistem grafik do të gjykohet si i përkryer, kur me një numër relativisht të vogël shkronjash është i aftë të shprehë në shkrim plotësisht dhe në mënyrë të thjeshtë anën tingullore të të folurit.

Nga kjo pikëpamje grafika e shqipes është një nga më të përkryerat. Me 27 shkronja (dy nga këto të pajisura me shenja diakritike) ajo shpreh plotësisht dhe në mënyrë të thjeshtë 36 fonemat e gjuhës. Po ta krahasojmë grafikën tonë me të gjermanishtes e të rusishtes, drejtshkrimi i të cilave bazohet në parimin fonematik, na del më qartë epërsia e sistemit grafik të shqipes. Kështu gjermanishtja, që ka gjith-

ashtu 36 fonema, për t'i shprehur ato përdor 30 shenja grafike, kurse rusishtja për 39 fonemat e saj përdor 33 shenja grafike.

Megjithëse shkronjat e përbëra ose digramet e shqipes si sasi zënë plot 0,25% të alfabetit (alfabeti ynë ka 9 digrame) në shkrimin e gjuhës pesha e tyre specifike është shumë e ulët. Sipas llogaritjeve që janë bërë për të përcaktuar dendurinë e përdorimit të 36 shkronjave të alfabetit të shqipes në tekste të lidhura me një gjatësi të përgjithshme prej 126.644 shkronjash, del se dyshkronjëshat e alfabetit tonë zënë 6.40% të tekstit. Pra në 1000 shkronja të një teksti të lidhur vetëm 64 prej tyre janë digrame. Kjo është një përqindje mjaft e ulët.

Po të shikojmë dendurinë e secilës nga digramet, na del kjo renditje: dendurinë më të lartë e ka *sh*-ja: 2.53%, duke zënë kështu vendin e 14-të në kuadrin e gjithë alfabetit, pastaj vjen *dh*-ja, e 21-ta, me 1.01%, *nj*-ja e 27-a me 0,67%, *gj*-ja e 28-ta me 0,65%, *rr*-ja e 29-ta me 0,50%, *ll*-ja e 30-ta me 0,47%, *th*-ja e 31-ta me 0,47% dhe *xh*-ja e *zh*-ja në vendin e 34-t e të 35-të me nga rreth 0,06%<sup>1)</sup>. Pra nga pikëpamja praktike digramet nuk përbëjnë ndonjë barrë të padureshme në shkrimin e shqipes.

Por pavarësisht nga kjo rrethanë, digramet, nga pikëpamja e grafikës duhen gjykuar nga fakti nëse sigurojnë një lexim të njëvlershëm të fjalëve ku përdoren apo jo, sepse kërkesa themelore e grafikës për një sistem shkrimi është që të sigurohet një lexim i njëvlershëm i fjalëve. Në qoftë se e njëjta fjalë mund të lexohet dy mënyrash, kjo është padyshim një e metë e grafikës.

Ata që vendosën alfabetin tonë të sotëm 64 vjet më parë në Manastir kanë bërë një punë të studjuar për përcaktimin e shkronjave të thjeshta që u përdorën për të formuar digramet. Njëra ose të dyja shkronjat e digramës shënojnë tinguj, që nga pikëpamja akustike e fiziologjike kanë anë të përbashkëta me tingullin që shënon digrama, kurse në rastet e *gj*-së e të *nj*-së shkronjat e veçanta të digramës shënojnë tinguj nga shkrirja e të cilëve në gjuhën shqipe ka dalë ose mund të dalë tingulli që shënon digrama. Pra zgjedhja e shkronjave për të formuar një digramë nuk është arbitrare, po e arësytuar, merr parasysh veçoritë fiziologjiko-akustike të tingullit të shënuar prej tyre. Por më me rëndësi është fakti se tingujt e shënuar prej këtyre shkronjave të thjeshta që përbëjnë një digramë nuk takohen kurrë njeri pranë tjetrit në trup të morfemave. Kështu në gjuhën shqipe, me ndonjë përjashtim të rrallë, nuk ka fjalë të thjeshta, të marra në formën e tyre përfaqësuese, ku të vijnë njeri pas tjetrit në shkrim dy tinguj si *g* ose *n* dhe *j*, ose *d*, *t*, *s*, *z*, *x*, dhe *h*. Këto shkronja dhe tingujt e shënuar prej tyre mund të takohen vetëm në kufi të fjalëve që përbëjnë një kompozitë dhe në shqipen e kohës së Kongresit të Manastirit këto raste kanë qenë mjaft të rralla. Takimet *g-j*, *n-j* mund të shkaktohen në formimin e një emri me prapashtesën *-je* prej një teme foljore më *-g* ose *-n*: *lag-je*, *dhën-je*; takimi *n-j* mund

1) Shih Faruk Besho, *Mbi mundësinë e rritjes së shpejtësisë së transmetimit të njoftimeve në telegrafi, duke marrë parasysh probabilitetin e përdorimit të shkronjave dhe fonemave të ndryshme në gjuhën shqipe*. «Buletin i USHT Seria shkencat natyrore», 1969 nr. 2, f. 113-120; khs. edhe recensionin tim në «Studime filologjike», 1969 nr. 3, ff. 226-228.

të shkaktohet edhe në formimin e emërores së shquar të emrave femërorë të formuar prej emrash mashkullorë më *-n*: *shaljan-shaljan-ja, dibran-dibran-ja, shkodran-shkodran-ja* etj.; takimi *g-j*, mund të lindë edhe gjatë zgjedhimit në të pakryerën të atyre dy-tri foljeve me temë më *-g* si *lag: lag-ja, lag-je* etj. si edhe në trajtën e shquar të emrave femërorë si *pedagoge-pedagog-ja, patologe-patolog-ja, teknologe-teknolog-ja*, emra që po shtohen përditë. Takimet e shkronjave *d, t, s, z*, me *h*-në mund të lindin gjatë formimit të kompozitave ose të fjalëve të prejardhura me parashtesën *mos-*, kur kjo i ngjitet një fjale që fillon me *h*: *shtat-hedhur, gjoks-hapur, mos-hyrje, gaz-hedhëse* etj. Të tilla raste në shqipen e kohës së Kongresit të Manastirit ose kanë munguar krejt ose kanë qenë shumë të rralla. Prandaj të gjitha digramet ose dyshkronjëshat e grafikës së shqipes u konsideruan sikur të ishin shenja të thjeshta dhe u lidhën vetëm me një vlerë tingullore. Për këtë arsye nëpër tekstet tona shkollore thuhet se alfabeti i gjuhës shqipe përbëhet prej 36 shkronjash (ato do të ishin 27, po të mos numëroheshin digramet si shkronja më vete), ndryshe pra nga sa ndodh me alfabetin e gjuhëve si frëngjishtja, anglishtja, gjermanishtja, ku kombinimet e shkronjave që përdoren për të shprehur një tingull nuk numërohen si shkronja më vete në alfabet. Si pasojë, në fjalorët e shqipes renditja e fjalëve bëhet jo duke u nisur nga shkronja e parë e digramës, por duke e marrë digramën si një shkronjë të vetme me një vend të saj in të caktuar në alfabet.

Pra në alfabetin dhe në grafikën e shqipes, me gjithë ekzistencën e digrameve, mbetet si parim themelor që një tingull të shënohet gjithnjë me të njëjtën shenjë dhe që e njëjta shenjë, e thjeshtë ose e përbërë, të përdoret për të shënuar gjithnjë të njëjtin tingull. Një sistem i tillë i alfabetit është kushti i parë, nga pikëpamja teknike, për të përpunuar një drejtshkrim fonetik, të thjeshtë për t'u përveçësuar dhe në pajtim me natyrën morfonematike të shqipes.

Kjo veçori e alfabetit tonë duhet pasur parasysh në përcaktimin e rregullave drejtshkrimore për rastet kur takohen dy shkronja që mund të lexohen si një fonemë e vetme. Shmangja, me mënyra të ndryshme, e këtyre takimeve përforcon parimin e grafikës së shqipes që një shenjë, e thjeshtë a e përbërë, të shprehë vetëm një tingull.

Po të shikojmë traditën tonë të shkrimit, vihet re se takimet *g* ose *n + j* në pjesën më të madhe të rasteve janë shmangur. Aq e fortë është ndjenja se *g* ose *n + j* nuk mund të jenë gjë tjetër veç *gj* e *nj*, sa që gjithkush që nuk ka vetëm aftësinë mekanike të përdorimit të shkronjave të alfabetit, po është në gjendje edhe të arsyetojë për këtë vështirësi që paraqet grafika, mundohet t'i shmangë takimet e shkronjave *g* ose *n* me *j*-në.

Për t'i shmangur këto takime mund të vihet si shenjë ndarëse, pa vlerë fonetike, një *ë* midis *g-së* e *j-së*, ose fonema *j* mund të paraqitet me shkronjën *i*. Zgjidhja e parë ka një shtrirje të kufizuar, në shtyp del rrallë. Kështu vërtet ruhet njësia grafike e prapashtesës *-je*: *djegëje, vënëje*, por shtohet në shkrimin e këtyre fjalëve një shkronjë pa vlerë fonetike dhe pa kurrfarë motivimi morfologjik a etimologjik, gjë që nuk mund të jetë e pranueshme për sistemin e

shkrimit të shqipes. Zgjidhja e dytë, shkrimi me *i* në vend të *j*-së, është më e thjeshtë, më praktike dhe më e përhapur në praktikën e shtypit. E meta e saj nuk është, siç pretendohet, se shkel parimin fonetik të drejtshkrimit të shqipes, pasi në rrokjen pastheksore zanorja *i* para një *e*-je nuk mund të lexohet veçse si *j* e jo si *i*, p.sh. *malarie*, *mumie*, *materie* etj., të cilat ne i shkruajmë me *i*. Kjo zgjidhje shton në grafikën e shqipes një rast të ri, kur një tingull-fonemë mund të shprehet me dy shkronja [*j*] — *j*, *i*, por ruan njësinë fonetike të digrameve *gj* e *nj* dhe e bën fjalën të lexueshme vetëm me një mënyrë. Për këtë arsye rekomandimi i projektit për të shkruar *gj*, *nj*, duke ruajtur vlerat e veçanta tingullore të secilës shkronjë, është kundërshtuar gjerësisht. Problemi bëhet edhe më i mprehtë po të kemi parasysh se numri i fjalëve, shkrimi i të cilave vuan nga kjo vështirësi e grafikës, është shtuar sidomos me emra femërorë të formuar prej emrash mashkullorë me *-g* ose *-n*: *pedagog-pedagoge-pedagogja*, kështu edhe *radiologja*, *biologja*, *partizanja*, *shaljanja* etj. Për këto arsye mendoj që drejtshkrimi i ri të respektojë parimin themelor të grafikës: fjala të lexohet vetëm në një mënyrë, dhe traditën drejtshkrimore, duke hequr dorë nga rekomandimi i projektit të 1967-s.

Përsa u përket takimeve: *d*, *t*, *s*, *z*, + *h*, që mund të shfaqen në kufirin midis dy gjymtyrëve të një kompozite; *shtat-hedhur*, *mes-hollë*, *gaz-hedhëse* etj., tradita e shkrimit, duke gjykuar sipas lëndës së kartotekave gjuhësore të Institutit të gjuhësisë dhe të letërsisë, paraqitet në këtë mënyrë: mjaft dendur gjymtyrët e kompozitës ose edhe parashtesa *mos-*, janë shkruar ndaras, si fjalë të veçanta. më rrallë me vizë lidhëse, por te emrat e përveçëm të huaj si *Et'hem*, *Mat'hauzen*, *Vald'hajm*, mbizotëron përdorimi i apostrofit, i cili ka marrë këtu funksionin e një shenje ndarëse.

Cila do të ishte mënyra më e përshtatshme për të shmangur këto takime? Vetëkuptohet se këtu vijnë në vështrim viza ose apostrofi. Ato kanë fituar tashmë vlerat e tyre si shenja drejtshkrimore. Përdorimi si shenjë ndarëse do të ishte për to një funksion i ri, që nuk duhet të bjerë në kundërshtim të theksuar me përdorimet e tjera të tyre. Nga kjo pikëpamje apostrofi paraqitet më i përshtatshëm se viza, pasi kjo e fundit ka marrë vlerën e një shenje bashkuese te disa tipe kompozitash dhe do të ishte krejt e panatyrshme, sidomos pas një parashtese si *mos-* (*mos-hyrje*). Apostrofi, përkundrazi, do të ishte më i përshtatshëm. Ai nuk do ta ndante fjalën në dy gjymtyrë, por do të shërbente thjesht si një shenjë ndarëse grafike, do të kishte pra një vlerë krejt konvencionale ashtu siç ka te *s'e ç'*.

Gjashtëdhjetë e katër vjetët që kanë kaluar që nga Kongresi i Manastirit nuk janë një periudhë shumë e gjatë. Për hir të së ardhmes ne do të kishim të drejtë të bënim ndryshimet e nevojshme në alfabetin tonë, për të shmangur të metat e tij, por këto si në aspektin teorik, ashtu edhe në aspektin praktik, nuk janë të tilla sa të përliqin një reformë të alfabetit. Mendoj pra që në Rregullat e drejtshkrimit që do të hartohen pas këtij projekti, të paraqitet në një pikë të veçantë alfabeti i gjuhës shqipe dhe vlerat e tingujve të tij.